

# Përshëndetje nga KENIA!

Kenia është në Afrikën Lindore. Mbi 50 milionë njerëz jetojnë atje.



## VIZITË NË KENIA

Në maj të vitit 2022, Plaku Ronald A. Rasband, vizitoi vendin e ndërtimit të Tempullit të Nairobot në Kenia. Ai tha se ishte një nga çastet e tij të parapëlqyera gjatë udhëtimit të tij në Kenia.

## TUFAT E FLAMINGOVE

Kur liqeni Nakuru ka shumë alga, mijëra flamingo vijnë për t'i ngrënë ato. Numri i flamingove mund ta bëjë të gjithë liqenin të duket ngjyrë rozë.



Asante!

Kjo do të thotë "Faleminderit" në suahilisht!

## VRAPUES TË SHQUAR

Kenia është vendi i shumë prej vrapuesve më të mirë në botë për vrapimet e gjata. Ata kanë fituar 106 medalje nga garat e vrapimeve në olimpiada.

## GJUHA

Kenia ka dy gjuhë zyrtare: suahilisht dhe anglisht. Atje fliten edhe dhjetëra gjuhë të tjera.

## Mamba

Fëmijët e luajnë këtë lojë anembanë Afrikës. Një lojtar është mamba (gjarpri) dhe qëllimi i tij është që të prekë të tjerët. Kur një lojtar prekët, ai ose ajo bëhet pjesë e mambas duke lidhur krahët. Vetëm personi i parë që është mamba mund të prekë lojtarë të tjerë. Lojtari që mbetet i fundit, fiton.

## RECETA

## Çapati

Ky është një ushqim i zakonshëm në Kenia. Ja ku është një variant që mund ta provosh!

1. Përziej **280 gram miell**, **3.2 gram kripë** dhe **8 gram sheqer** në një tas të madh.
2. Shto pak nga pak rreth **295 ml ujë të ngrohtë** dhe përzije. Ndaje brumin në gjashtë topa.
3. Përdor një okllai për t'i hapur petët në rrathë. Spërkat gjalpë mbi secilën prej tyre.
4. Mblidhi petat role dhe jepu formë spirale. Më pas rrafshoji spiralet në rrathë të hollë me okllai.
5. Gatujti në një tigan me vaj në zjarr mesatar nga të dyja anët derisa të marrin ngjyrë kafe të artë.

*Sigurohu që të marrësh ndihmë nga një i rritur.*